



KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 001/060 – 145030

Më: 12 nëntor 2024

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 12 nëntor 2024, në Sallën e mbledhjeve të KPF-së, në “Shtëpinë e Bardhë”, me fillim në ora 10:10 minuta.

Pjesëmarrës nga KPF-ja, ishin: Antigona Bytyqi, Kryesuese e KPF-së, Karanfil Haxhillari, Dafina Alishani, Adem Shabanaj, Naxhije Memaj Florent Ukaj, Egzona Hoxhaj Levent Buş dhe Bajram Kastrati, të gjithë anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pjesëmarrës tjerë ishin: Kujtim Gashi, Nënkyetar i Komunës, Luljeta Veselaj Gutaj nga DASH, Halil Likaj nga DEF, Pranverim Berisha dhe Shpresa Osmanollaj nga DUPH, Mybexhele Zhuri nga Zyra për Barazi Gjinore dhe të Drejtat e Njeriut dhe Gursel Skenderi nga Sektori i Pronës, si dhe OJQ-të e Mediat.

Antigona Bytyqi: Përshëndetje të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, i nderuar Nënkyetar, drejtorë, media dhe gjithë ju të pranishëm. Pra për sot siç po e shihni kemi thirrur mbledhjen e radhës të Komitetit për Politikë dhe Financa. Prezent jemi nëntë anëtarë, pra të gjithë jemi prezent dhe mund të fillojmë me punimet e kësaj mbledhje. Për rend dite për sot kemi:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-rregullores për dhënien e dekoratave nga komuna e Prizrenit;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i planit lokal të veprimit për barazinë gjinore (2024-2026);
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr.001/011-95083 të datës 18.07.2024;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr. 001/011-14771 të dt. 27 janar 2022, sipas Rekomandimit të Komitetit për Komunitete;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-planit Zhvillimor Komunal të Arsimit 2025-2027;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit Përzgjedhës (DKA);
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimin për miratimin e Planit Rregullues të Hollësishëm “Zona e Parkut për Industri të Lehtë në Prizren – Parku i Biznesit” sipas Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit;
9. Raporti financiar janar – qershor dhe janar – shtator 2024;
10. Raporti i Këshillit për Trashëgimi Kulturor të Qendrës Historike të Prizrenit për periudhën gusht 2023- qershor 2024;
11. Informatë rreth përfundimit të vitit shkollor 2023/2024 dhe informatë rreth fillimit të vitit të ri shkollor 2024/2025;
12. Diskutim rreth raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Prizrenit për vitin 2023 dhe planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve për vitin 2023;
13. Informatë rreth raportit të punës të Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB), për periudhën janar-gusht 2024;
14. Raporti i Performancës Komunale për Komunën e Prizrenit, për vitin 2023

Pa humbur kohë po fillojmë menjëherë me pikën e parë.

Pika e parë:

Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës;

Antigona Bytyqi: Nëse ka dikush diçka me shtuar rreth rendit të ditës, ndonjë propozim apo diçka? Po drejtor urdhëro.

Sulltan Badalli: Unë pata diçka ne kemi, na ka dalë një kërkesë tjetër nga ministria, gjegjësisht Departament i Thesarit, për shkak se për muajin nëntor dhe dhjetor ka disa probleme për pagesat e pagave, janë mungesë të mjeteve për shkak që dihet kontratës kolektive. Andaj na është obliguar që me bë një harmonizim të këtyre pagave dhe me parë ku janë tepricat edhe mangësitë edhe na kanë obliguar që duhet me kaluar përmes kuvendit. Po mendoj që është mirë me futë në rend dite dhe që t'i rekomandohet edhe kuvendit. Faleminderit.

Antigona Bytyqi: Faleminderit drejtor për propozimin. Po Karanfil urdhëro.

Karanfil Haxhillari: Faleminderit Kryesuese. Përshëndetje anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa. Neve jemi dëshmitarë që disa seanca e kemi pasur shqetësimin tonë si kuvendar lidhur me anëtarët e komisionit për përzgjedhës për drejtorat edhe pavarësisht diskutimeve të disahershme të cilat i kemi bërë, personi për të cilin kemi folur dhe i kemi pasur kritikën tona edhe si komitet por edhe si kuvend nuk është bërë asnjë ndryshim! Prandaj kërkoj që kjo pikë derisa nuk vjen me një ndryshim, pra pika e shtatë e rendit të ditës që është shqyrtimi dhe miratimi i propozim=vendimit formimin e komisionit përzgjedhës, unë kisha propozuar me e hjekë, arsyet i kemi dhënë në kuvend që për për mos me u zgjatë edhe këtu, arsyet i kemi dhënë edhe në kuvend, edhe disa herë këtu. Komuna e Prizrenit ka ekspertë të arsimit, komuna e Prizrenit, ka njerëz të tjerë të cilët e kishin kryer punën, nuk jemi bllokues të këtij komisioni sikur qysh ka ndodhur më herët. Vetë drejtoresha është mburrë sepse e kemi mbështetur edhe neve në komisionet e mëhershme, por ama çka është e tepërt është e tepërt. Kjo arrogancë dhe injorancë pavarësisht të gjitha kritikave që i kemi pas si kuvendarë, vazhdon prapë i njëjti emër të na silltet në këtë komision! Prandaj kërkoj që kur ta bjen drejtoresha apo kush e bënë propozimin e këtyre anëtarëve një emër tjetër, jo ky, pra fjala është për Arben Shalën, atëherë edhe ne e mbështesim. Por derisa është ky anëtar i komisionit kërkoj që kjo pika e rendit të ditës të hiqet dhe në seancën e ardhshme të silltet një emër tjetër në mënyrë që me proceduar për në kuvend.

Antigona Bytyqi: Faleminderit Karanfil. Dikush tjetër? Po Florenti e ka fjalën.

Florent Ukaj: Faleminderit, përshëndetje për të gjithë. Edhe ne si LDK e mbështetim propozimin e shefit të Lëvizjes Vetëvendosje. Përderisa nuk ndryshohet emri i këtij personi kur dihet që në shumicën e rasteve është i përfolur për shumë afera madje edhe disa inçizime që kanë dalë në publik për përzgjedhjen dhe fyerjen e disa personave që ka bërë në ato. Ne si LDK propozojmë që derisa nuk ndërrohet ky emër edhe ne propozojmë që të hiqet nga rendi i ditës. Faleminderit.

Antigona Bytyqi: Faleminderit Florent. Dikush tjetër? Po Dafina urdhëro.

Dafina Alishani: Faleminderit Kryesuese. Unë sinqerisht nuk po e kuptoj këtë insistimin e ekzekutivit apo dhe kryetarit, tash nuk e di kush po e propozon. Diskutimet janë bërë disa herë edhe nuk e di qysh po mundemi për një emër me e dështu disa herë një kuvend, e pika e tjera po na zhagiten pastaj. Nuk është bre diçka e pamundur që po kërkohet, nuk është kjo vetëm kërkesë e opozitës, unë jam e sigurtë që shumica e anëtarëve nuk janë të kënaqur me pas një ekspert të pavarur të tillë sepse kemi pasur fakte, ne nuk po aludojmë diçka që nuk e kemi dëgjuar, nuk po aludojmë diçka që nuk është e vërtetë. Nuk kemi diçka kundër politikisht, por kjo moralisht nuk

do të duhej të pranohej as nga ekzekutivi, as nga kryetari për shkak që ka pas premtime publike që nuk do të lejohet politizimi. Edhe pse nuk po merret parasyshtë kërkesa. e legjislative? Pse po duhet na gjithmonë me bërë zhurmë jashta normales edhe me pas dështime të seancës, me pas fyrje në kuvend? Një kërkesë legjitime e legjislativit është dashur me u marrë parasyshtë. Ne nuk po themi që jemi për me e bllokuar assesi, por me ardhë me emër të njëjtë i bie që edhe fuqia e legjislativit po anashkalohet komplet. Ju lutem kushdo që e propozon, qoftë kryetari, qoftë drejtoresha, le ta ketë parasyshtë këtë, le të vjen me një emër tjetër, le ta bëjnë propozimin dhe në rregull jemi.

Antigona Bytyqi: Faleminderit, dikush tjetër? Në qoftë se nuk ka, atëherë u dhanë dy propozime. Një nga drejtori, pra harmonizimi i pagave dhe meditjeve në komunën e Prizrenit për dy muajt e fundit të vitit. Po shkoj propozimet po i hedhim një nga një në votim, se cilat do të kalojmë e cilat jo pastaj edhe rendin e ditës. Propozimin e parë që e propozoj drejtori? Po e konsideroj edhe unë si Kryesuese një pikë jashtëzakonisht me rëndësi, kështu që kisha kërkuar edhe unë me mbështetë. Prezent jemi tetë anëtarë, unanimisht, ju faleminderit. Propozimi tjetër është që të largohet pika e shtatë. Kush është për që të largohet këto pikë nga rendi i ditës? Prezent jemi 8 anëtarë, pesë jemi për, zero kundër dhe tre abstenim. Atëherë largohet pika e shtatë nga rendi i ditës. Tash propozimi i ri domethënë...,

Luljeta Veselaj Gutaj: Kryesuese veç një koment rreth kësaj, dhe një pyetje e kam për anëtarët e Lëvizjes Vetëvendosje. Meqë e atakojnë zakonisht një anëtar i cili ka qenë dhe ka kryer një punë shumë të mirë, ekselent e ka kryer, nuk kanë asnjë argument, munden me thënë afera, por duhet me dhënë përgjegjësi për afera kur flet siç e tha kolegu këtu. Pse Ministria e Arsimit e ka përzgjedh Arben Shalën me të gjithë këto aferat që ju aludoni, që t'i bëjë strategjitë, që të jetë në komision për hartimin e teksteve shkollorë? Pse Qeveria e Republikës së Kosovës e ka marrë Arbenin, e ka thirrë për me punu strategji? Dhe pse shumë komuna që udhëhiqen nga Lëvizja Vetëvendosje e thirrën për me i ndihmu në aspektin e arsimit? Hajde ma jep një përgjigje. Se meqë është kaq, a e din ka kaq shumë afera edhe që flisni ju, ju aludoni dhe keni përgjegjësi për atë.

Dafina Alishani: Drejtoreshë, po më shqetëson shumë fakti që goxha paskit informata për Arbenin se nuk ish dashur që kaq shumë bre me u marrë në këtë komision, as me me bekgroundin e anëtarëve.

Luljeta Veselaj Gutaj: Jo po ta bëjë pyetjen se kur akuzon një person që ne si drejtori e kemi propozuar dhe punon për qeverinë, po punon për ministri dhe ti po aludon për këtë person, kjo është nonsens. Veç le ta merrë vesh opinionin publik se ku jemi.

Antigona Bytyqi: Ju lutem flisni me radhë për shkak të procesverbalit.

Dafina Alishani: A po më dëgjon, kur po ju konvenon shumë mirë po referoheni për MASHT, kur juve nuk po ju konvenon po e shani MASHT-in!

Luljeta Veselaj Gutaj: Jo jo, ta kujtova dhe ta tregova një të vërtetë reale.

Dafina Alishani: Thu ti nuk dinë me vlerësu këta kur ka ndonjë send, ose kur nuk e investojnë ose kur nuk keni ndonjë takim diçka, nonstop atakoni qeverinë! Tash pse pazaret e juaja po ju mbështetka një anëtar.

Luljeta Veselaj Gutaj: Do të mbanë përgjegjësi për këtë fjalë, ku është ai Pazar? Ku është ai pazar, cili Pazar? Ke me mbajtë përgjegjësi për fjalët që po i thu ti.

Dafina Alishani: Ka dalur një inçizim i Arben Shalës, a po më ndëgjon?

Luljeta Veselaj Gutaj: Jo s'të ndëgjoj, kur të flet për pazare, jep përgjegjësi.

Dafina Alishani: Pazaret që i kemi ndëgju.

Luljeta Veselaj Gutaj: Cili është ai pazar? Mbjaj përgjegjësi për fjalët që po i thu.

Dafina Alishani: A po don me ta hap audio-inçizim?

Luljeta Veselaj Gutaj: Ku është ai Pazar? Ku flitet emri im?

Dafina Alishani: Lulja edhe Shaqa, kush është Lulja edhe Shaqa?

Luljeta Veselaj Gutaj: Ki mu përgjigj në organe të drejtësisë, edhe dalin argumentet, edhe ti shumë mirë e din.

Dafina Alishani: Argumentet i ki te protali Insajderi, e ki zanin e tij.

Luljeta Veselaj Gutaj: Dëgjo, ne po jetojmë ku s'mund me pi një kafe e me bë muhabet me një mik apo me një shok se të inçizon. Kategoritë e tyre që ti shumë mirë e njeh edhe personin, për një pozicion që.

Dafina Alishani: Çka ka inçizu është me rëndësi. Unë çka ju kam thënë në kuvend, ky ka qenë ekspert tepër i respektuar, i gjithë qyteti e ka respektuar Arben Shalën.

Luljeta Veselaj Gutaj: E respekton tan Kosova e jo veq qyteti.

Dafina Alishani: Falë pazareve dhe trikave të juaja e keni denigruar njeriun! Po më vjen keq...

Luljeta Veselaj Gutaj: Mbaje në mend fjalën pazar.

Dafina Alishani: Inçizimet i keni.

Luljeta Veselaj Gutaj: Po qoji inçizimet, janë organet e drejtësisë oj Dafinë, nuk je ti prokurore e as gjyqtar me e qitë të drejtën, as unë e as tjetri. Nuk guzon me interferu në këtë pjesë. 12 min.

Dafina Alishani: Na nuk mundemi me kanë qekaq naiva me dëgju një njeri çfarë trika bënë edhe me i mbyllë sytë edhe me ju votu prapë. Çka u bë tash që po referoheni te ministria?

Luljeta Veselaj Gutaj: Jo por pasi që paska pasur qesi skandale sipas jush, qysh e përzgjedhët ju pikërisht këtë?

Dafina Alishani: Garant ai zyrtari i PDK-së që është atje.

Antigona Bytyqi: Ju lutem t'i lëmë diskutimet pasi që veç u hjek nga rendi i ditës, të vazhdojmë me pikat tjera të rendit të ditës.

Karanfil Haxhillari: Veç edhe një përgjigje. Unë jam kuvendar në Komunën e Prizrenit.

Luljeta Veselaj Gutaj: Shumë mirë që s'keni çka me folë e po mirreni vetëm me këtë pikë! Vazhdoni, ju pafsha qeshtu.

Karanfil Haxhillari: Nuk është qeshtu drejtoreshë sepse kemi plot me çka me u marrë.

Luljeta Veselaj Gutaj: Vazhdoni merruni vetëm me Arben Shalën sepse s'keni diçka tjetër.

Karanfil Haxhillari: Ty po të duket ashtu. Unë jam kuvendar i Kuvendit Komunal në Prizren dhe unë e përcjelli punën për të cilën paguhem këtu në Prizren, çka ndodh atje, edhe nuk kam qasje edhe nuk e di, tash po marr vesh!

Luljeta Veselaj Gutaj: Jo ajo është publike, konkurset janë publike, unë i shoh në faqe të ministrisë.

Karanfil Haxhillari: Dhe tash unë kundërpyetjen po ta bëjë. A është, apo të duket fer, pikën e gjashtë e kemi shqyrtimi dhe miratimi i projek-tplanit zhvillimor komunal të arsimit i bërë nga Arben Shala, në shqyrtim menjëherë pikën e shtatë anëtari i komisionit prapë Armend Shala. Tash okej, kërkush s'po mohon që është ekspert i arsimit, kërkush nuk po e mohon këtë, mirëpo trikat e tija as ti mos ja moho, trikaxhin dhe trikat e tija mos ja moho as ti.

Luljeta Veselaj Gutaj: Karanfil veç një gjë, kjo është e fundit. Mua më intereson anëtari i komisionit me kryer detyrën me përgjegjësi në aspektin ligjor edhe me zgjedh me një meritokraci. U pa, ne i kemi dhe dëshmitë që janë kanë anëtarë njerëz që e kanë përcjellë procesin edhe që e kanë shkruar qysh ka shkruar procesi, qysh ka përfunduar. Qysh do me ngjyrosë, me përshtatë edhe me formatizuar sipas formatit që ty të pëlqen cilido proces, aty e bënë, e bënë politikisht i jepë ngjyrë politike. Po a u krye një proces në mënyrën më të mirë të rregullt? S'ka diskutim, a ka njerëz.

Dafina Alishani: Sipas Jush.

Luljeta Veselaj Gutaj: Jo sipas meje oj Dafinë, ato janë vendime të organeve të drejtësisë ndaj personave toksik të cilët kanë tentuar me çdo kusht me pasë një pozicion të drejtorit! Edhe pse lufton bash me çdokush një x person.

Karanfil haxhillari: E pse po lufton edhe ti bash qekey me kanë pra?

Luljeta Veselaj Gutaj: Jo bre unë e kam propozu, unë s'jam tuj luftu veç qekey.

Karanfil Haxhillari: Po që sa seanca je tuj e sjell qeta?

Luljeta Veselaj Gutaj: Jo, ajo ka mbetë u përcjellë se s'janë vazhduar seancat, ka mbetë pika.

Dafina Alishani: Arsye pse s'janë vazhduar seancat ka qenë mu ky emër.

Luljeta Veselaj Gutaj: Sepse e ka kryer punën më së miri, me përgjegjësinë më të madhe.

Dafina Alishani: Jo bre drejtoreshë, ju po thuani që ka shkruar procesi në rregull sipas juve!

Kujtim Gashi: Neve na ka kry boll punë, tash ja kemi dhënë qeverisë Arbenin.

Dafina Alishani: A po e sheh.

Kujtim Gashi: Për ne s'po bëjka e për ata po bëjka.

Luljeta Veselaj Gutaj: Për qeveri bënë, për ministrinë e arsimit bënë a për neve jo.

Antigona Bytyqi: Ju kisha lutur, jemi te shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës. Kush është për që të miratohet ky rend i ditës?

Dafina Alishani: Me ndryshime apo?

Antigona Bytyqi: Po me ndryshime, me u largu pika e shtatë dhe me u futë pika e re. Prezent jemi 8-të anëtarë kush është për? Unanimisht, ju faleminderit.

E kam një propozim në qoftëse pajtoheni edhe ju, meqë e tregoi rëndësinë e kësaj pike, kisha propozuar që të jetë ndër pikat e para ose e para propozimi i ri, ë qoftëse pajtoheni edhe ju?

Egzona Hoxhaj: Po Kryesuese, Harmonizimi i pagave të del në fillim.

Antigona Bytyqi: Ju të tjerët a jeni për? Unanimisht, ju faleminderit. Vazhdojmë me pikat tjera, te pika e re pasi e qitëm të parën.

Pika e dytë

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për harmonizimin e pagave dhe meditjeve në Komunën e Prizrenit në dy muajt e fundit të vitit 2024;

Antigona Bytyqi: Drejtor a ke nevojë me e marrë përsëri fjalën për këtë pikë? Apo t'i lëmë sqarimet për në kuvend?

Sulltan Badalli: Nuk është problem. Siç e thashë, do të ketë mungesë për muajin nëntor dhe dhjetorë për shkak të pasojës së kontratës kolektive, përmes përmbarimit janë marrë mjetet sidomos në arsim pjesa dërmuese është, pjesa prej 952 mijë eurove është mungesë. Ka qenë mbi 1 milion, mirëpo në disa drejtori kemi bërë harmonizim që ka pas ngapak tepricë dhe i kemi grumbulluar, por totali i mbetjes është 952 mijë euro. Ne këtë vendim që do të merret nesër në kuvend, duhet me e dërgu në ministri dhe ata duhet me na bë një zgjidhje sepse komuna nuk ka mundësi. Çka ka patur mundësi të vogla ato vlera janë inkorporuar brenda drejtorive, janë mbledh edhe janë shpërndarë sidomos te arsimi, se problemet më të mëdha janë te arsimi.

Antigona Bytyqi: Faleminderit Drejtor.

Karanfil Haxhillari: Veç me e rikujtu edhe unë pak më mirë se s'jam ekonomist, por që i bjen sepse në një debat që e patëm më herët, kemi thënë që s'ka pas procese përmbaruese nga kontratat kolektive edhe u mburr që u bë një marrëveshje diçka. Mirëpo këtu tash po del që paska pasur raste, ta sqarojmë këtë se...

Sulltan Badalli: Vazhdimi ki, në mënyrë të vazhdueshme e ki atë. Bile është shumë e ndieshme sepse na marrin mjetet pa paralajmërim edhe nuk na tregojnë! Më herët na kanë dërguar një shkresë ku me i marrë mjetet. Ka raste për projekte kapitale, por kanë marrë edhe në arsim, ka edhe kësi raste.

Karanfil Haxhillari: Po se në debatin Jeta në Kosovë u tha që nuk kemi pasur, kemi pasë marrëveshje, kemi gjetur marrëveshje edhe nuk kemi pasur kësi probleme.

Kujtim Gashi: Në përmbarues të qojnë edhe operatorët.

Karanfil Haxhillari: Jo për kontratën kolektive u kanë.

Antigona Bytyqi: A ka dikush tjetër diçka? Në qoftëse jo, atëherë po e hedhi në votim. Prezent jemi nëntë anëtarë, kush është për që ti rekomandohet mbledhjes së ardhshme? Unanimisht, ju faleminderit të gjithëve. Kalojmë te pika tjetër.

Pika e tretë:

Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-rregullores për dhënien e dekoratave nga komuna e Prizrenit;

Antigona Bytyqi: Fjalën e ka Nënkryetari për këtë pikë.

Kujtim Gashi: Faleminderit kryesuese, ju përsënder të gjithëve. Siç e dini, fillimisht ne kemi pasur planifikim me plotësu rregulloren të vjetër, por ndërkohë gjatë punës, grupit punues, me mbështetjen e USAID-it, është dashur, është parë që ka nevojë me u ndryshu pjesa dërmuese e rregullorës edhe për shkak të disa çmimeve të reja edhe e kemi bërë një rregullore të re e cila po besoj do të jetë model për komunat për shkak se është prej të parave që po bëhet si e till me USAID-in. Besoj qysh keni mundur me e parë, janë një numër i madh i çmimeve të reja që janë përfshirë, prej çmimit Nënë Tereza, Çmimi për Trashëgimi që s'ka ekzistuar në rregulloren e vjetër Edi Shukriu, Çmimi Vrapuesja e Prizrenit, Çmimi për Inovacion dhe Teknologji, sigurisht që atëherë kur është bërë rregullorja e vjetër, kjo fushë ka qenë pak e zhvilluar edhe tash e dimë që është një trend në zhvillim, sidomos pjesa e inovacionit dhe teknologjisë edhe kemi paraparë një çmim për ata që punojnë në këtë fushë. Çmimi vjetor për zyrtarin publik të dalluar, është bërë të kaluaren e keni parë me një farë vendimi të kryetarëve të komunave çdo vit, por tash e kemi pararë në rregullore. Çmimi për qytetari aktive, çmimi për gratë në udhëheqje Leze Qena, çmimi ndërmarrësi i vitit, çmimi për shërbim në komunitet, kjo është pak më shumë për këshillat e fshatrave dhe të lagjeve që bëjnë punë edhe është mendu që ata që janë shumë aktiv që kryejnë punë për komunitetin me pas natyrisht edhe një çmim. Çmimi për të arriturat në fusha të ndryshme e kemi lënë si të përgjithshme, aty ku s'ja kemi qëlluar në rregullore e kemi një opsion të mundshëm për me mbuluar. Edhe çmimin mirënjohje dhe falenderimet që bëhet prej Zyrës së Kryetarit të Komunës. E veçanta e Rregullorës në dallim prej rregullores së kaluar por edhe të gjitha rregulloreve është se ju e keni parë që saherë janë dhënë çmimet ose është shpallur ndokush Qytetar Nderi, e kemi pasë njëfarë pllakate, njëfarë shiriti që ja kemi qitë, por s'ka pas diçka të veçantë. Tash, te neni 27 e kemi paraparë që përzgjedhja e modeleve të dekoratave të bëhet nëpërmjet një konkursi publik, domethënë komuna e shpallë një konkurs publik qysh ka mu dokë X dekorata, për secilën dekoratë ka mu zgjedhë, domethënë ka me u përcaktu me konkursin publik dhe kanë me qenë domethënë modele ose dekorata zyrtare të komunës së Prizrenit sipas kësaj rregulloreje. Poashtu, disa prej çimeve parashihet me u mbulu edhe me mjete financiare, besoj që kjo do të përkrahet, jo të gjitha çmimet por një pjesë e çmimeve domethënë përcillen bashkë edhe me një pjesë të vogël të mjeteve financiare, natyrisht si motivim për punën edhe angazhimin që e kanë bërë ata në vazhdimësi. Unë, po e falenderoj edhe Kryesuesen që ka qenë pjesë e punës edhe grupin punues e veçanarisht USAID-in. Janë mbajtur disa puntori me ta, disa veç ne edhe kemi ardhur deri te finalizimi i këtij dokumenti që është jashtëzakonisht i nevojshëm për komunën sepse deri tash do çmim që është dhënë nuk ka pasur ndonjë farë baze apo modeli zyrtar siç parashihet tash me rregulloren e re. Ju faleminderit.

Antigona Bytyqi: Faleminderit Nënkryetar. A keni ndokush diçka ndonjë koment apo me parashtrë ndonjë pyetje? Po urdhëro Bajram.

Bajram Kastrati: Faleminderit Kryesuese, përsënder të gjithë. Pa dashur me përmend emra të llojet e çmimeve, po më duket këto titujt, çmimet a ka pasur edhe ndonjë emër tjetër që e keni diskutuar paraprakisht para se me vendos emrin të ndonjërit prej çmimeve. Ta marrim për shembull çmimi për gratë në udhëheqje Leze Qena, a kemi pas ndonjë një emër tjetër që është diskutuar?

Kujtim Gashi: Në fakt Bajram, një kriter i përgjithshëm në diskutimin tonë që emrat të çmimet duhet me qenë njerëz të Prizrenit, domethënë ose kanë lindur në Prizren ose kanë pasur veprimtari në Prizren, domethënë që e lidhin për Prizrenin. Te emri për të cilin po flet, ka pasur diskutime, ka pas diskutime edhe për emra të tjerë, po si përfundim kemi ardhur te Leze Qena, për shkak të shumë arsyeve

Bajram Kastrati: Se tash çmimi për gratë në udhëheqje edhe po më duket s'di sa po përputhet me Leze Qenën!

Kujtim Gashi: Pse çka pengesë?

Bajram Kastrati: Tash si artiste....

Antigona Bytyqi: Ka thyer barriera.

Bajram Kastrati: Po mirë de, por a kemi pas edhe emra të tjerë? A kemi të drejtë së paku me diskutu edhe për emra të tjerë?

Kujtim Gashi: Patjetër që po. Veç përmendi kush është sepse unë s'po mundem me gjetë! të gjalla ka, por të vdekura.

Bajram Kastrati: Jo jo, të gjalla, unë e mora veç njërin prej çmimeve, po thash a keni diskutuar edhe për emra tjerë pa dashtë...

Kujtim Gashi: Po te tregoj te çmimi për trashëgim kulturore, një orë debat kemi pasur, unë jam kanë për një opsion tjetër, por prap kemi ardhur në përfundim që Edi Shikriu e mbulon më së miri këtë çmim për shkak të kontributit që e ka dhënë në këtë fushë.

Dafina Alishani: Kënd tjetër e keni pasur?

Kujtim Gashi: Kemi pasur shumë emra po ata kryesisht për shembull Anton Pashku, emër i madhë në letërsi edhe për qeta më kanë mujt.

Karanfil Haxhillari: Për trashëgimi kulturore paskët pasur debat, por prap më mirë baba i kësaj Muhamet Shikriu, mendoj që ka dhënë më shumë kontribut sidomos për Prizrenin.

Kujtim Gashi: Kush?

Karanfil Haxhillari: Babai i kësaj, Muhamet Shukriu.

Kujtim Gashi: Po e vërtetë, por në komision kemi pas shumë gra, na kanë mujtë.

Egzona Hoxhaj: Përnime ju pse po jeni burrat kundër grave?

Karanfil Haxhillari: Po flas për kontribute, s'po flas për gjini.

Kujtim Gashi: Unë mendoj se sikur Edi Shukriu, mund të jenë edhe 1 ose 2 persona në mbarë shqiptarinë, që kanë dhënë kontribut në fushën e trashëgimisë sa kjo, kjo ka botime të jashtëzakonshme edhe ndërkombëtare.

Naxhije Memaj: Po, Profesor Doktor.

Kujtim Gashi: Po përtej asaj.

Bajram Kastrati: Megjithatë për secilin ka fjalë, megjithatë u dashtë një diskutim pa më i gjërë. Tash në momentin kur e diskutojmë tash në asamble na duhet me përmend një emër pse nuk është ky tjetri edhe. Para se me ardhë si rregullore u dashtë njëfarë diskutimi, njëfarë punëtorie me kanë të përfshin të gjithë nga pak.

Antigona Bytyqi: Ka qenë grupi punues.

Kujtim Gashi: Grupi Punues e ka kryer atë në dëgjim publik.

Karanfil Haxhillari: Po veç mua shumë po më duken 18-të!

Kujtim Gashi: Pse? Sa më shumë aq më e pasur. Nuk e ki obligim ti me i shfrytëzu krejt titujt.

Dafina Alishani: Meqë ka shumë tituj, unë këtu te çmimi për gratë në udhëheqje këtë pjesën e udhëheqjes e kisha heqë, sepse ti ke gra që s'janë në udhëheqje edhe ish dashtë me marrë çmime. Pse po i kufizojmë vetëm me një rol? Se diqysh gjithmonë po shkojmë te gratë që kanë arritë një standard edhe veç qata po i asi gra. Gruaja e vitit ti mundesh me zgjedh ndoshta një diçka që ka kontribuar edhe nuk është në udhëheqje.

Antigona Bytyqi: E kemi tek pika 14-të, më fal që po të ndërpres.

Dafina Alishani: Te shërbimi në komunitet. Mendoj që rinia ishte dashur me pasë një çmim sepse gjithmonë po i bëjmë këto aktivitete, rinia gjithmonë është e anashkaluar. Tash nuk e di çfarë të riut t'ia gjejmë emrin ose me lënë si te inovacioni dhe teknologjia, veç emri çmimi për rininë e vitit. Po krahas këtyre titujve, unë e kam një propozim, s'di a mundemi me fuzionuar këtu në këtë rregullore? Për secilën titull që jipet, komuna e Prizrenit me e mbjellë një pemë sepse këto mirënjohje, dekoratat e merr personi por duhet me pasë edhe një pjesë në qytet që me pasuru diçka, për shembull me e pas më të gjelbërt me e gjetë një park, ose një hapësirë të re sepse unë jam e sigurtë që ka me pasë shumë tituj por këtyre titujve bile t'ia sheh hajrin qyteti. Për secilin titull, ndoshta me e lënë edhe emrin qytetar i nderit i 2024 edhe me shku komuna DSHP-ja me e mbjellë për secilin titull nga një pemë. Se titulli i cili i jepet është njëfarë nderi për atë person, po çka po përfiton komuniteti? Nëse është e mundur, tash nuk e di a mundet me u planifikuar kjo mirë, me pas një kënd të gjelbërt, kushdo që kalon atje edhe i lexon, edhe ja sheh hajrin, e bënë një pjesë më të gjelbërt. Sepse unë jam e sigurtë si qysh ka pasur shumë tituj e nganjëherë edhe është keqpërdorur, bile këtë keqpërdorim ta përdorim për diçka pozitive për qytet. Me e shtuar një nen, për secilin titull që jipet, komuna obligohet ta mbjellë nga një pemë.

Karanfil Haxhillari: Jo veç. këtu ku është 1000€, i falen, a jipen së bashku edhe një pemë me mbjellë.

Egzona Hoxhaj: Me atë çmim e mbjellë vetë.

Kujtim Gashi: Se i mbeta pak borgj Bajramit. Këto çmimet që kanë qenë lokale si kemi prekë. Domethënë e ke prej 1 deri te9, dhe 8 si kemi prekë se kanë qenë çmime që janë në rregulloren e vjetër. Te propozimi i Dafinës, ç'kado që prekim këtu ne mundemi me ndryshuar sepse në fund të fundit vendimi i fundit është i juaji, ju e votoni me ndryshuar. Po besoj që kjo rregullore përmbledhë shumë çka. Nëse një qytetar na e shpallim me një çmim të caktuar, ai paraprakisht ka dhënë një kontribut për qytetin sepse përndryshe pse e shpallim edhe qatij ja ka pa hajrin qyteti. Tash nëse po u dufka me mbjellë një pemë, nuk është ndonjë problem i madh, por se di a duhet me qenë bash e vendosme kjo punë edhe në rregullore!

Dafina Alishani: Po se e obligon.

Kujtim Gashi: Edhe te çmimi për rini, rinia e ka të veçantë, nuk është në rregullore, për shkak se Udhëzimi Administrativ parasheh që me u shpallë vullnetari i vitit. Karta e vullnetarit njih çmime të veçanta që përcaktohen me Ligjin për Rini, për atë arsye se kemi përmbledh këtu, për shkak se ata kanë çmime të veçantë e cila përcaktohet me ligjin e tyre, për mos me e dupliku.

Dafina Alishani: Edhe te çmimi ndërmarrësi i vitit, ndoshta a bën ndërmarrësi/ndërmarrësja, mos ta bëjmë gjininë se ka edhe

Kujtim Gashi: Po veç tek titujt nuk ndërrohet gjinia, qaty është problemi. Veç te na Kosovë thojnë ministrja, në Shqipëri ministri thuhet, ose titujt në gjuhën shqipe nuk kanë gjini, ashtu e thotë gjuha shqipe.

Dafina Alishani: Po mirë, propozimin për pemë a e propozojmë këtu apo në kuvend? S'di qysh po i duket kolegëve të tjerë?

Kujtim Gashi: Nëse vendoset me shku qashtu, duhet me një propozim në kuvend me arsyetim. Secili çmim këtu që ka ardhë, ka ardhë me arsyetim.

Dafina Alishani: çmim jo, vetëm një nen me e shtu, domethënë qysh e kemi paraparë dekorata si bëhet, çmimi qysh asi edhe në fund veç me e pas për çdo çmim të ndarë...

Kujtim Gashi: Duhet me përcakuar cilat çmime se për shembull mirnjohje dhe falenderime munden me kanë 200.

Egzona Hoxhaj: Jo jo, te këto çmimet kryesore po besoj, këto 18-të.

Kujtim Gashi: Te propozimi duhet me përcaktu cili çmim duhet me mbjellë pemë.

Dafina Alishani: Tek çdo çmim që jipet.

Egzona Hoxhaj: Po i bjen te llojet e dekoratave po mendojmë.

Dafina Alishani: Tek dekoratat.

Karanfil Haxhillari: Neni 26, për shembull ku e kemi procedura dhe ceremonia për dhënjen e dekoratave. Qeky nen kur thotë: dorëzimi i dekoratave bëhet... pastaj është neni 4, përveç dekoratës titulli të gjitha dekoratat të tjera shoqërohen me një shpërblim financiar me 1.000€ edhe këtu me shtu diçka, të gjitha këto....

Kujtim Gashi: 1000€ dhe mbjellen nga një fidan, apo qeshtu?

Dafina Alishani: Veç me e shtuar nga komuna e Prizrenit.

Karanfil Haxhillari: Jo ai me e mbjellë vetë a po kupton?

Bajram Kastrati: A ka nevojë me e ditë edhe lokacionin ku është? Për shembull formën e vendosjes së emrit, ku vendoset?

Dafina Alishani: E aty tani kur e hapim këtë thirrjen për dekoratë, mirë është me e bashkangjitetë aty që është edhe ajo pjesa që shkruhet për çdo pemë, se ai që e merrë tenderin për 1 vit e din sa dekorata kanë me u bë, krahas dekoratave e bënë edhe mbjelljen e një peme.

Antigona Bytyqi: A ka dikush tjetër me shtuar diçka rreth kësaj pike? Në qoftëse jo, atëherë po e hedhi në votim edhe këtë pikë që t'i rekomandohet mbledhjes. Prezent jemi-të anëtarë, kush është për? Tetë jemi për, zero kundër dhe një abstenim. Atëherë kalojmë te pika e tjetër.

Pika e katërt:

Shqyrtimi dhe miratimi i planit lokal të veprimit për barazinë gjinore (2024-2026);

Antigona Bytyqi: Zonja Mybexhele paska ardhur përsëri, e kemi diskutuar njëherë.

Mybexhele Zhuri: Unë nuk e di ka nevojë përsëri, por unë kisha dashur vetëm këto ndryshimet të cilat ndodhën pasi që e patëm një takim, pasi që kishim një vërejtje për mospërfshirjen e grave deputete edhe pse patë konsultim publik, po s'ka dert. Unë i ftova po erdhën vetëm tre vetë, dy dhanë kontributin e vetë edhe janë të përfshira tash e keni pranuar besoj planin me ndryshim. Është pika 11.2 ku prej zonjës Shukrije patëm një propozim, pasi që është kryetare e një Bashkësie Lokale, si pikë e kemi shtuar identifikimin e nevojave dhe organizimi i një trajnimit apo aktiviteteve për fuqizimin e kapaciteteve për gratë dhe burrat të zgjedhur si kryetarë të fshatrave apo këshillave lokale. Mua mu duk e arsyeshme edhe e kemi përfshirë në këtë pjesën e parë.

Karanfil Haxhillari: Në krejt komunën e Prizrenit, vetëm dy janë.

Mybexhele Zhuri: Po dy janë, por plani i parasheh dhe burrat jo veç gratë. Te pika 3.18 kemi publikimin e historive të grave të suksesshme në biznes për të frymëzuar të tjerët si dhe përdorimi i platformave sociale për të ndarë mesazhe, citate apo përvoja lidhur me gratë në sipërmarrje. Pika 3.9, bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile që mbështesin gratë në biznes për të organizuar aktivitetet e fushatat. Edhe 3.1.10 shënimi i ditës së grave, kjo ishte propozimi i zonjës Ymrane Fusha, për shënimin e ditës së grave-22 shtatori, përmes eventeve, seminare, konferenca, punëtori ose organizimin e tyre në panele, që trajtojnë temat si barazia gjinore, ndërmarrësi dhe zhvillimi i karrierës për gratë. Kanë qenë të arsyeshme, por prapë se prapë kjo do të del në shqyrtim në asamblenë komunale, nëse ndokush ka diçka. Në fillim se harrova, tek fjala e kryetarit patëm një vërejtje se këtu shkruan Prizreni vatra e dijes dhe shkollimit shqiptar, e kemi shtuar turk e boshnjakë dhe të komuniteteve të tjera, sepse duhet t'i përfshijmë të gjithë. Unë e kisha propozimin vetëm për turk e boshnjak, por më duket se janë edhe të tjerë, atëherë do ta shtojmë edhe komunitetet të tjera sepse të gjitha jetojnë në Prizren.

Antigona Bytyqi: Faleminderit znj. Mybexhele. A ka dikush me shtuar diçka? Në qoftë se jo atëherë po e hedhi në votim edhe këtë pikë. Kush është për që t'i rekomandohet mbledhjes? Unanimisht, ju faleminderit shumë. Kalojmë tek pika e radhës.

Pika e pestë:

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr.001/011-95083 të datës 18.07.2024;

Antigona Bytyqi: Pra siç e dini kemi marrë vendimin për formimin e një komisioni vlerësues, edhe pse na ka ardhë konfirmimi ligjshëm nga MAPL-ja, pastaj në ditën e konstituimit siç jeni të njoftuar anëtarja nga OJQ-të ka dhënë dorëheqje edhe neve na duhet me të plotësim-ndryshimin e vendimit dhe sëvendësimin e këtij personi. Në qoftë se keni një pyetje diçka me shuar rreth kësaj pike? Besoj që emri do të vjen në kuvend nesër, normal nëqoftë se kalon edhe hyn në rend dite.

Karanfil Haxhillari: A bënë veç një pyetje përtej kësaj, por që lidhet me këtë pikë të rendit të ditës. A është ndryshuar vendimi, sepse bëhet fjalë për të tek parku Yllka ajo pjesa apo? Komisionin Vlerësues për atë pronën aty. A është ndryshuar diçka sepse atje u ndryshuar diçka, a është ndryshuar diçka edhe në vendim të komunës?

Gursel Skenderi: Në vendim të komunës nuk u ndryshu asgjë. Kryesuesja sië tha veç domethënë anëtarja nga OJQ ka dhënë dorëheqje, tash prapë ai vendim duhet me u plotësue për OJQ-të, ka edhe tjetër s'u ndryshue kurrëgjë, qashtu domethënë edhe vendimi mbi dhënien edhe vendimi i komisionit njëjtë është.

Karanfil Haxhillari: Sepse atje tash janë hjekë a e din që kanë qenë të mbululume, tek ai parku janë hjek ato edhe thjesht mendova që është ndryshuar edhe vendimi, sepse kzekutivi mundet me ja dhënë apo mos me ja dhënë edhe sado kudo pse ka pas shumë ankesa prej banorëve apo për atë destinim po mendova rastësisht mos është ndryshuar diçka..

Gursel Skenderi: Nëse ndryshohet, çdo gjë duhet me shku përmes kuvendit.

Antigona Bytyqi: Faleminderit. Dikush tjetër? Në qoftë se nuk ka, atëherë po e hedhi në votim edhe këtë pikë që t'i rekomandohet mbledhjes së ardhshme. Kush është për? Prezent jemi 9-të anëtarë, gjashtë jemi për, zero kundër dhe tre abstenim. Aëherë miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës, ju faleminderit. Kalojmë te pikta tjetër.

Pika e gjashtë:

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të datës 27 janar 2022 sipas rekomandimit të Komitetit për Komunitete,

Antigona Bytyqi: Pra komuniteti Rom ka parashtruar një kërkesë te Komiteti për Komunitete, për shkak që një anëtare më duket që për arsye personale jeton diku në Gjermani apo nuk e di pse, nuk po merrë pjesë në mbledhjet e komitetit edhe komuniteti Rom duan që ta zëvendësojnë me një anëtare të re. Pastaj Komiteti për Komunitete na ka parashtruar neve kërkesën që ka paraqesim këtu, kështu që në qoftë se kemi pyetje emri do të jetë në rekomandim i propozuar. A keni dikush diçka me shtuar? Në qoftëse jo, po e hedhi në votim edhe këtë pikë. Kush është për që t'i rekomandohet mbledhjes? Unanimisht, ju faleminderit. Kalojmë te pika tjetër.

Pika e shtatë;

Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-planit zhvillimor komunal të arsimit 2025-2027.

Antigona Bytyqi: Drejtoreshë, fjala për juve.

Luljeta Veselaj Gutaj: Faleminderit Kryesuese. Plani zhvillimor i arsimit për komunën e Prizrenit 2025-2027, është një produkt i punës së përbashkët të personelit të Drejtorisë së Arsimit, drejtorëve të shkollave, mësimitdhënësve, komunitetit të prindërve dhe shumë organizatave të tjera joqeveritare, po ashtu dhe qytetarëve arsimdashës në Prizren, të cilët me komentet e tyre e kanë plotësuar dhe e kanë begatuar planin zhvillimor për 3 vitet e ardhshme. Është hartuar përmes një procesi të strukturuar mirë, ka objektivat, plani zhvillimor i ka shtatë objektiva strategjike, nga një për secilën fushë me interes është qeverisje, udhëheqësje dhe menaxhim cilësor në të gjitha institucionet edukative arsimore të komunës së Prizrenit. Mjedisi shkollor i përshtatshëm për zhvillimin e procesit mësimor dhe aktivitete jashtë kurrikulare. Përmirësim domothënës i mësimitdhënies dhe të nxënimit në shkolla. Ndërtim i vazhdueshëm i kapacitetit për mësimitdhënies cilësore. Përmirësim i vazhdueshëm i cilësisë së mësimitdhënies dhe të nxënimit në shkolla. Bashkëpunim cilësor dhe efikas mes hisedarëve të edukimit të hershëm dhe ndërlidhja më e mirë e arsimit profesional me tregun e punës. Pa dashur me u lëshuar në detaje, besoj që e keni pas mjaftueshëm këtë dokument, dokumenti ka qenë edhe në diskutim publik një kohë të gjatë, ka pas shumë puntori, shumë tryeza, shumë diskutime dhe konsideroj dhe kërkoj mbështetje e anëtarëve të kuvendit, por dhe të komitetit për me futur në votim. Vizioni i planit zhvillimor të arsimit janë të përgatitshëm qytetarë me shprehje të të nxënimit gjatë gjithë jetës, të mveshur me kompetenca dhe vlera të qytetarisë aktive, të cilat kontribuojnë në zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, shoqëror dhe kulturor. Misioni i Drejtorisë së Arsimit përmes këtij plani zhvillimor është një sistem gjithëpërfshirës dhe llogaridhënës i arsimit, me menaxhim cilësor dhe mësimitdhënës të përgatitur me mjedise krijuese dhe kushte që sigurojnë. edukim dhe arsim cilësor të fëmijëve. Për pyetje jam këtu për t'ju përgjigjur.

Antigona Bytyqi: Faleminderit drejtoreshë për prezantimin. A keni dikush diçka për me shtuar.

Karanfil Haxhillari: Kemi por po e lëmë në kuvend.

Antigona Bytyqi: Në rregull, atëherë po e hedhim në votim edhe këtë pikë që t'i rekomandohet mbledjes. Prezent, prezent jemi 8-të anëtarë, kush është për? Gjashtë jemi për, zero kundër dhe dy abstinim. Domethënë edhe kjo pikë i rekomandohet mbledhjes. kalojmë te pika tjetër.

Pika e tetë;

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimin për miratimin e Planit Rregullues të Hollësishëm "Zona e Parkut për Industri të Lehtë në Prizren – Parku i Biznesit" sipas Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit;

Antigona Bytyqi: Fjala për juve drejtor.

Pranverim Berisha: Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë. Pra ne jemi në fazën e fundit tashmë të planit rregullues për zonën ekonomike Parku i Biznesit, dy faza paraprake ne i kemi kaluar, tashmë ka ardhur deri aty dokumenti sa që e ka marrë fazën edhe finale për miratim të këtij dokumenti. Faktikisht, drejtorja bashkë me operatorin i cili ka qenë edhe fitues për hartimin e këtij plani rregullues, domethënë e ka bërë gati që ky dokument me u miratu në asamble dhe me vazhduar domethënë pjesën tjetër për konfirmim të ligjshmërisë dhe kështu ne e plotësojmë edhe pjesën grafike e cila është mungesë në hartën zonale. Prandaj kishim kërku që t'i rekomandohet kuvendit për miratim. Edhe ashtu jemi na jemi vonë si Prizren, që nga 2009 domethënë bëhet fjalë për zonën ekonomike e faktikisht u dashtë edhe këto pengesat ligjore me i kalu si Prizren. Ju faleminderit.

Antigona Bytyqi: Faleminderit drejtor. A keni ndokush me shtuar diçka? Po Bajram. Urdhëro.

Bajram Kastrati: Faleminderit Kryesuese. Më kujtohet para nja dy viteve drejtor e kam bërë një pyetje shumë direkte, kur ka me filluar implementimi ose punë te Parku i Biznesit? Përgjigja prej nënkrytarit ka qenë brenda gjashtë muajve! Kështu që, veç po du me ditë a është faza përfundimtare, cila fazë përfundimtare, se sa fazat ne i kemi votuar këtu, sa projektet e juaja i kemi votuar edhe nuk e dimë kur ka me filluar! A bënë atë pyetjen e para dy viteve edhe njëherë me ditë kur ka me filluar puna te zona industriale?

Pranverim Berisha: Dëgjo Bajram, ne si Drejtori e Urbanizmit, domethënë jemi duke e plotësuar një mungesë në hartë zonale edhe ajo është na është rekomanduar, edhe në komunikim me Ministrinë e Planifikimit që duhet të shkohet përmes domethënë hartimit të rregullues të hollësishëm. Se kur aktivizohet dhe kur bëhet funksional është kompetencë e Kryetarit të Komunës e jo e Drejtorisë së Urbanizmit.

Shpresa Osmanollaj: Për gjashtë muaj ti Bajram.

Bajram Kastrati: Për gjashtë muaj keni thënë edhe para dy viteve!

Karanfil Haxhillari: Dëgjo Bajram, Parku i Biznesit është projekt, baza e projektit është në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, këta veç që i kanë pjesën e Drejtorisë Planifikimit të Urbanizmit, a baza është te Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik. Këta veç punët e veta, për gjashtë muaj kanë thënë, që katër vjet vetëm hala jemi në këtë drejtori! për me dalë te tjetra, pastaj.....

Antigona Bytyqi: Veç ju kisha lutur mos flisni në të njejtën kohë, për shkak të pocesverbalit.

Bajram Kastrati: Jo edhe përgjigja që po thotë zyrtarja e nderuar për gjashtë muaj, për gjashtë muaj, është injoruese! Se nënkryetari para dy viteve na ka thënë për gjashtë muaj ka me u funksionalizu zona.

Kujtim Gashi: Kush ka thënë?

Bajram Kastrati: Nënkryetari zotëri Kujtim Gashi.

Kujtim Gashi: Unë a?

Bajram Kastrati: Po para dy viteve, por ke harruar çfarë ke thënë para dy viteve edhe tash drejtori po thotë që është në kompetencën e kryetarit. Atëherë na po u dashka me pyet kryetarin ose nënkryetarin. Pyetja ke e para dy viteve, kur ka me filluar me u funksionalizu zona industriale, kur kemi me filluar punën aty? Para dy viteve, para dy viteve keni thënë brenda gjashtë muajve! 49.14 min.

Kujtim Gashi: Jo s'keni thënë qashtu, por ta arsyetoj.

Bajram Kastrati: Jo, e gjejmë ne procesverbalin, para dy viteve keni thënë brenda 6 muajve!

Pranverim Berisha: Janë problemet që kanë dalë aty në hartë zonale.

Kujtim Gashi: Drejtori pak ta tha, aty problemet kanë dalur njëri pas tjetrit! Disa i kemi ditur e disa jo për me qenë të sigurtë. Paraprakisht ajo s'ka qenë e përfshime në hartë zonale hiç pjesa grafike, tani u dashtë me hy e me bë këtë farë plani që po bëhet, tani ka dalë problem me pronat do private do të AKP-së, deri në zgjidhjen e tyre. Tek tash këto probleme janë eliminuar edhe është duke u punuar në finalizim. A mundem me të thënë për gjashtë muaj apo pesë, se di a muj me thënë, por besoj me më pyet mua nesër, jo për shkak që duhet po për shkak që e nevojshme edhe kërkesë e jashtëzakonshme e shumë investitorëve. Prizreni normal po humb çdo ditë investitorë serioz për shkak të kësaj hapësire.

Bajram Kastrati: Jo, thashë nëse nuk mundet me u funksionalizu, me këqyr ndonjë formë me Komunën e Suarekës mos po munden me na ba një zgjidhje.

Kujtim Gashi: Kurgjo s'ka Komuna e Suharekës, ajo vjen përmes asamblesë, qashtu edhe na e japim. Por ne duhet me rregulluar njëherë tokën, ai veç i ka dhënë në shfrytëzim tokat, kurrjë s'ka bë.

Florent Ukaj: Jo, boll ka bë.

Kujtim Gashi: Ama ajo zone nuk është, ajo veç në shfrytëzim.

Bajram Kastrati: Bizneset po funksionojnë.

Kujtim Gashi: Ndoshta qashtu edhe ne e bëjmë sepse s'kemi opsion tjetër.

Florent Ukaj: Ani çka po pritni?

Kujtim Gashi: Kadale se menjëherë nuk mundet me e dhënë, duhet me rregullu atë, duhet me pasë plan.

Antigona Bytyqi: Po Dafina urdhëro.

Dafina Alishani: çka kryhet pas gjashtë muajve? A është pjesa urbanistike ose procedurat që kanë të bëjnë me drejtorinë e urbanizmit edhe pastaj vijnë të tjerat sepse është edhe çertifikimi si zonë.
Kujtim Gashi: S'kem asi opsion.

Dafina Alishan: Pse s'keni?

Kujtim Gashi: Nuk bëhet ajo punë.

Pranverim Berisha: Liçensimi.

Dafina Alishani: Po, a bëhet liçensimi pastaj prej..

Shpresa Osmanollaj: Plani rregullues është konform të gjitha normativave. Në radhë të parë konform hartës zonale, konform udhëzimeve administrative paavarësisht që po diskutohet, por janë respektuar të gjitha udhëzimet administrative edhe për licencim edhe për parqet industriale, është një udhëzim i ri. Por për këtë fazë e kemi vetëm miratimin e hartimit të planit rregullues, kurse procedura të tjera prapë gjithqysh kanë me shku.

Dafina Alishani: Kjo zgjatë gjashtë muaj apo...

Shpresa Osmanollaj: Jo jo, kjo hyn në fuqi me miratimin e planit. andej i shkojnë ato procedurat e formimit të komisioneve, partneret privat apo qysh janë ato procedura që s'kanë të bëjnë me urbanizmin. Pjesa e urbanizmit është hartimi i planit regullues.

Dafina Alishani: Domethënë gjashtë muaj i bjen aktivizimi i zonës.

Shpresa Osmanollaj: E mandej ajo pjesa tjetër, po për gjashtë muaj besoj.

Dafina Alishani: Okej. Te emri nime me sa e di unë, një zonë tjetër ka qenë për industri të lehtë dikah tjetër.

Shpresa Osmanollaj: E me normativat teknike të planifikimit, me normativat e reja është bërë ndryshimi i emrit por është parku i biznesit., s'njeh më park të biznesit tamam në atë kuptimin klasik që e kemi pas përpara, por industri e lehtë. Ne gjithmonë e kemi quajtur si zonë e parkut të biznesit, e kemi shti sepse për shkak të normativave teknike të planifikimit, nuk njihen më këto terminologji të mëhershme. Në bazë të asaj është kthyer, por është e njëjta zonë, me të njëjtat...

Dafina Alishani: A mos ka pasur edhe një zonë tjetër sipas hartës zonale?

Shpresa Osmanollaj: Këqyre, zona të industrisë ka plot sipas hartës zonale, por zona e industrisë si park i biznesit për me i dhënë tokat për shfrytëzim është kjo zonë, zonat e tjera janë prona private.

Kujtim Gashi: është tek tranziti atje, quhet zonë e lehtë megjithëse s'ka toka të komunës aty.

Shpresa Osmanollaj: Aty janë prona private, janë paraparë zonë industri e lehtë, kurse publike është vetëm kjo pjesë.

Kujtim Gashi: Me planifikime janë disa zona.

Karanfil Haxhillari: Nëse më lejohet veç pak, shihe kur e lexova titullin edhe menjëherë më shkoj mendja ku është pjesa mes dy tranzitëve përmbi Petrovë, mendova për ato sepse aty janë bërë do rrugë.

Kujtim Gashi: S'ke mendu keq, edhe ajo është zonë por në këtë rast po flitet për tjetër.

Shpresa Osmanollaj: Ajo është promë private, investime për favorizim, normal infrastrukture...

Karanfil Haxhillari: Për shkak të emërimit, domethënë unë u orientova andej a po kupton? Edhe mendova për atje.

Dafina Alishani: A bënë edhe një pyetje drejtor?

Pranverim Berisha: Po urdhëro.

Dafina Alishani: Së fundmi, kur jeni takuar me ministrinë lidhur me këtë zonë? Ose a keni pasë ndonjë komunikim me ta? A jeni në koordinim me ta?

Pranverim Berisha: Ndëgjo, unë gjithmonë flas për pjesën e planifikimit, domethënë që është bërë plani rregullues i hollësishëm. Unë kam pasur tre takime edhe në bazë të rekomandimeve të tyre ne kemi sukses, domethënë kur shkon konfirmimi me u marrë i shqyrtimit të ligjshmërisë nuk na kthehen prapë, s'paku në dy fazat paraprake ka qenë kështu. Suzana Goranci është domethënë Shefe e Departamentit të Planifikimit edhe zyrtarët tjerë ligjorë. Vazhdimisht domethënë kam

pasur me këta akter takim, tashmë jemi në fazën finale, miratimi që ne kemi respektuar udhëzimet e Departamentit Planifikimit nga Ministria e Planifikimit, kemi ardhur deri këtu, këtu përfundon puna e urbanizmit, me miratimin e asamblesë dhe konfirmimin e ligjshmërisë nga ana e ministrisë. Ne pjesën grafike e cila ka munguar në hartë zonale, tanimë e kemi plotësuar përmes planit rregullues të hollësishëm.

Dafina Alishani: Duhet me vetë Drejtorin e Zhvillimit Ekonomik. Mua po më intereson në pjesën e ministrisë së tregtisë. A ka takim ose jo, ju si ekzekutiv? s'keni pasë!

Kujtim Gashi: Mos u ngutë, veç deshta me të dhënë një informatë. Në Kosovë vetëm një zonë është e liçencume është zona në Drenas, ka liçencë, është zonë e shtetit që e mbikëqyrë Ministria e Tregtisë, asnjë zonë në Republikën e Kosovës nuk ka liçencë. Krejt janë të formës së Suharekës, i japin pronat publike në shfrytëzim edhe domethënë qekjo është zona, kush don me marrë toka, qe ku i keni.

Dafina Alishani: Pra me ligj duhet me pasë liçencë.

Kujtim Gashi: Po veç unë po tregoj që tash me ja nisë mbi një vit sun e kryen.

Dafina Alishani: Pse?

Kujtim Gashi: Sepse duhet me i marrë nja 20 pëlqime nëpër institucione të ndryshme.

Antigona Bytyqi: Ju faleminderit. A ka dikush tjetër me shtuar diçka rreth kësaj pike? Nëqoftë se jo, atëherë po e hedhi në votim edhe këtë pikë. Kush është për që t'i rekomandohet mbledhjes së ardhshme? Prezent jemi 9-të anëtarë, Unanimisht, ju faleminderit. Pikat të tjera, për të gjitha janë bë diskutime, vetëm po i hedhi në votim për rekomandim. Raporti financiar janar qershor dhe janar shtator 2024. Prezent jemi 8-të anëtarë, kush është për? Unanimisht, ju faleminderit. Raporti i Këshillit për Trashëgimi Kulturore? Unanimisht ju faleminderit. Informatë rreth përfundimit të vitit shkollor dhe informatë rreth fillimit të vitit shkollor? Unanimisht. Diskutim rreth raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit? Unanimisht, ju faleminderit. Informatë rreth raportit të punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm? Unanimisht faleminderit. Raporti i performancës komunale për komunën e Prizrenit për vitin 2023? Unanimisht, ju faleminderit. Ju falënderoj për kontributin dhe pjesëmarrjen në këtë mbledhje, shihemi nesër në mbledhjen e kuvendit.

Përfundoi në ora: 11:09 minuta.

